

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I PËR APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-147/11

Prishtinë

31 maj 2012

Në çështjen ligjore të:

R.B.P.

I përfaqësuar nga **M.M.M.**

Paraqitësi i kërkesës/Pala ankuese

Kolegji i Apelit të AKP-së i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët: Anne Kerber, Kryetare e Kolegjit, Elka Filcheva - Ermenkova dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/AR/101/2011 (lënda është e regjistruar në AKP me numrin KPA47389), të datës 23 shkurt 2011, pas shqyrtimit të mbajtur me 31 maj 2012, mori këtë:

AKTGJYKIM

- 1- **Pranohet ankesa e R.P. si e bazuar.**
- 2- **Prisheet vendimi i Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPKK/D/AR/101/2011, i datës 23 shkurt 2011, për sa i përket kërkesës të paraqitur me 30 nëntor 2007 nga M.M. në emër të R.P., e regjistruar me numër KPA47389, dhe lënda i kthehet në rishqyrtim Komisionit.**
- 3- **Shpenzimet e procedurës do të përcaktohen nga Komisioni.**

Përmbledhja procedurale dhe faktike:

Me 30 nëntor 2007, M.M. kishte paraqitur dy kërkesa në Agjencionin Kosovar të Pronës (AKP) në emër të vjehrrit të tij, i cili ishte i hospitalizuar dhe invalid, duke kërkuar të drejtën e pronësisë dhe të posedimit mbi ngastrën kadastrale – tokën Nr. “1367/” [përmirësim: 1367/1], në vendin e quajtur “Pade-Kodra/Pode-Brdo” zona kadastrale Batllavë në Komunën e Podujevës, klasa e 4-të, kullosë në sipërfaqe prej 0 ha 24 ari 15 m² (e regjistruar në AKP si lëndë KPA47389, e regjistruar në Gjykatën Supreme si GSK-KPA-A-147/11).

Ai kishte theksuar se vjehri i tij ishte pronar i pasurisë së sipërcekur, se kishte humbur posedimin me datë 15 qershor 1999 dhe se ngastra ishte uzurpuar nga personi i panjohur.

Për të mbështetur kërkesën e tij, ai kishte prezentuar në AKP vendimin N.nr. 51/73, me 26 shtator 1985 nga Gjykata Komonale e Podujevës, me të cilën është bërë pjesëtimi i ngastrave kadastrale, me ç’rast ngastra kadastrale 1367 i është caktuar R.P.. Ai, gjithashtu, kishte ofruar vendimin Nr. 466-48/92 të Komunës së Podujevës të datës 3 qershor 1993, duke ia pranuar R.P. dhe personit tjetër, të drejtën e kalimit në palujtshmërinë e tyre përmes ngastrës Nr. 2495 e cila gjendet në zonën kadastrale të Batllavës.

Sekretariati Ekzekutiv i AKP-ës kishte bërë njoftimin e kërkesës. Me 23 qershor 2008, ekipi i njoftimit të AKP-ës kishte vënë lajmërimin në ngastrën Nr. 1367/1, duke theksuar se palujtshmërija

ishite objekt kontesti i kërkesës dhe se palët e interesuar do të duhej të paraqitnin përgjigjet e tyre mbrenda 30 ditësh. Parcela nuk ishte e uzurpuar. Me datë 21 qershor 2010, AKP-ja kishte përsëritur njoftimin. Sidoqoftë, këtë herë ata nuk kishin vendosur njoftimin në ngastër, por përmes publikimit në Gazetën Zyrtare të AKP-ës Nr. 2 kishin bërë njoftimin e kërkesës. Gazeta i ishte lënë Udhëheqësit të Fshatit Batllavë si edhe disa institucioneve zyrtare dhe ishte vendosur në hyrje dhe dalja të Batllavës.

Raporti verifikues i AKP kishte konstatuar validitetin e vendimit të Gjykatës Komunale të Podujevës. Sekretariati Ekzekutiv sipas detyrës zyrtare në lëndë kishte inkorporuar edhe fletën poseduese Nr. 338 të zonës kadastrale të Batllavës, Komuna e Podujevës, duke vënë në pah se ngastra kadastrale – toka në fjalë ishte regjistruar në emër të R.P..

Në periudhën kohore midis korrikut 2008 dhe prillit të viti 2009, Sekretariati Ekzekutiv disa herë dhe pa sukses i kishte kërkuar M.M. të ofronte autorizimin e dhënë atij nga ana R.P. si bartës i të drejtës pronësore.

Komisioni për Kërkesa Pronësore të Kosovës me vendimin e tij KPKK/D/AR/101/2011 të datës 23 shkurt 2011, kishte refuzuar kërkesën e paraqitur për arsyet se M.M. nuk ishte anëtar i familjes së ngushtë ashtu siq përcaktohej me nenin 1 të Udhëzimit Administrativ (UA) të UNMIK-ut, të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, dhe se nuk i kishte ofruar AKP-ës autorizimin e dhënë nga bartësi i të drejtës pronësore edhe pse atij i ishte dhënë mundësia disa herë të bënte atë.

Vendimi i KPKK-ës i është dorëzuar M.M. me datë 28 korrik 2011 dhe ai kishte ushtruar ankesën kundër vendimit të sipërcekur me datë 25 gusht 2011.

Në ankesën e tij M.M. kishte atakuar vendimin e KPKK-ës për shkak të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe shkeljes esenciale të dispozitave të ligjit. Ai i kishte ofruar Gjykatës Supreme autorizimin e nënshkruar nga R.P. dhe të vërtetuar me datë 23 mars 2011 – VR. II Nr. 20/2011 – nga Gjykata e Prokupljes në Serbi. Me këtë autorizim R.P. kishte autorizuar M.M. të paraqes kërkesë në AKP në lidhje me palujtshmërinë e uzurpuar si dhe të ushtrojë mjete të tjera juridike si dhe të ndërmarrë veprime të tjera faktike dhe juridike në lidhje lëndët që janë të regjistruara në AKP.

M.M. kërkon nga KPKK të revokojë vendimin e tij dhe t'i njohëtë drejtën e posedimit R.P. në ngastrën 1367/1.

Arsyetimi ligjor:

1. Kërkesa e M.M. duhe të interpretohet si një ankesë përmes së cilës ai ka kërkuar nga Gjykata Supreme të prish vendimin e KPKK-ës dhe që kërkesa e paraqitur të pranohet.

Vendimi i shkallës së parë i është dorëzuar përfaqësuesit të ankuesit M.M., me datë 28 korrik 2011. Sipas nenit 12.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50, e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, pala mund të ushtroj ankesë mbrenda tridhjetë (30) ditësh nga dita e njoftimit të vendimit. M.M. në emër të R.P. kishte ushtruar ankesën e tij mbrenda afatit të paraparë ligjorë, me datë 25 Gusht 2011.

2. Gjykata Supreme konsideron se KPKK-ja në mënyrë të drejtë ka zbatuar rregullat për sa i takon përfaqësimit të palës. Sidoqoftë, kjo do të thotë se vendimi i ankimuar ishte bazuar në shkelje esenciale të dispozitave procedurale (Neni 182.1 i LPK-ës). Përfaqësuesit të paraqitësit të kërkesës nuk i është kërkuar formalisht që të përmirësoj dhe plotësoj kërkesën e paraqitur. Kërkesa e bërë vetëm përmes telefonit nuk ishte e mjaftueshme, por ishte e nevojshme një kërkesë me shkrim e cila do të tërhiqte vërejtjen e tij mbi pasojat nëse ai nuk i përmbahej kërkesës së tillë.

- a. Për sa i përket përfaqësimit të palës, neni 5.2 i UA 2007/5 i ndryshuar thekson: *“Në procedurën para Komisionit, kur personi fizik nuk mund të paraqes kërkesën, kërkesa mund të paraqitet nga antari i familjes së ngushtë të atij personi. Paraqitësi i kërkesës mund të autorizohet nga një person fizik mbi bazën e autorizimit valid dhe të vërtetuar. Në rastet e veqanta, kur dispozitat e autorizimit janë problematike, Sekretariati Ekzekutiv mund të vërtetojë një document tjetër duke autorizuar përfaqësimin e paraqitësit të kërkesës.*

Në përputhje me nenin 1 të të njejtit UA, *“anëtarë i ngushtë i familjes d.m.th bashkëshortja, fëmijë dhe persona të tjerë për të cilët bartësi i të drejtës pronësore është i obliguar t'i mbështesë sipas ligjit të aplikuar, ose personat të cilët janë të obliguar të mbështesin bartësin e të drejtës pronësore në pajtim me ligjin e aplikueshëm, pa marrë parasysh nëse personi banon në palujtshmëri së bashku me bartësin e së drejtës pronësore”*

Në rastin konkret, KPKK-ja ka vendosur drejtë se M.M. duhet të paraqes autorizimin. Bartësi i të drejtës pronësore, R.P. është i hospitalizuar dhe invalid. Situata e tillë mjafton për të konkluduar se ai është në pamundësi që të paraqes kërkesën vet, prandaj ai edhe mund të jetë i përfaqësuar. M.M. është dhëndërr i tij dhe si i tillë në bazë të ligjit të familjes së Kosovës Nr. 2004/32 ai nuk është i detyruar që të mbështes vjehrrin e tij. Prandaj, ai nuk është anëtar i ngushtë i familjes. Si rrjedhojë, me qëllim që ai të autorizohet të përfaqësoj R.P., që sikur edhe cek KPKK-ja, në këtë lëndë, ai duhet të ofroj autorizimin valid.

- b. Sidoqoftë, Gjykata Supreme gjykon që vendimi i KPKK-ës që të refuzojë kërkesën e paraqitur për shkak të mos ofrimit të autorizimit nuk është nxjerrë në përputhshmëri me dispozitat që i referohen plotësisht të kërkesës së paraqitur.

Neni 11.1 i Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2006/50 i Ligjit Nr. 03/L-079 parashikon që dispozitat ligjore të Ligjit të Procedurës Administrative duhet të aplikohen përshtatshëmrisht në procedurën para Komisionit. Neni 39.1 i Ligjit Nr. 02/L-28 i Procedurës Administrative parashikon: *“Nëse kërkesa për të filluar procedurën administrative e palës së interesuar nuk ishte përgatitur në përputhshmëri me kërkesat e përcaktuara në Nenin 38 të këtij ligji, personat fizikë dhe juridik mund të kërkojnë nga organi administrativ përmirësimin e pasaktësive në kërkesë”*

Midis kritereve/kushteve nga Neni 38 i këtij ligji, është edhe detyrimi se për t’u ushtruar kërkesa ajo duhet të përmbaj, nënshkrimin dhe datën e personit ose të përfaqësuesit ligjor të personit.

Gjykata Supreme është e mendimit se fjalët *“duhet të kërkojë përmirësimin”*, në kontekst të kërkesës së paraqitur para gjykatës, i referohen kërkesës formale duke përfshirë edhe citimin për sa i përket pasojave që mund të shkaktohen për shkak të mos përmbajtjes së instruksioneve që zakonisht bëhen në lëndët për të cilat zhvillohen procedurat para gjykatave.

Ky opinion gjithashtu mbështetet në detyrimet dhe përgjegjësitë e Sekretariatit Ekzekutiv ashtu siq janë përshkruar në Aneksin II të UA 2007/5 të ndryshuar, kryesisht në nenin 1.1 (a) dhe 4.1: Sekretariatit Ekzekutiv i është kërkuar të: *“ndihmojë mbledhjen e kërkesave”* dhe, që me kohë të ofroj zgjidhje për kërkesat e paraqitura *“të asistoj te palët për zgjidhjen e kërkesave”*.

Me qëllim të interpretimit të këtyre dispozitave të UA, Gjykata Supreme, ashtu siq është paraparë me Nenin 13 të të njetit UA, *“... duhet të marrë parasysh, me modifikime apo kritere të tilla për të cilat konsideron se janë të nevojshme apo të dubura në rrethana të caktuara, dispozitat e ligjeve në fuqi mbi kompetencat e Gjykatës Supreme lidhur me procedurat civile duke përfshirë mutatis mutandis dispozitat e Urdhërësës së UNMIK-ut Nr. 2002/13 mbi Themelimin e Dhomës së Veçantë të Gjykatës Supreme të Kosovës që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit”*.

Neni 28.4 i UA të UNMIK-ut Nr. 2008/6 që ndryshon dhe zëvendëson UA të UNMIK-ut Nr. 2002/13 për sa i përket kriterëve të pranueshmërisë së kërkesës parasheh që në rastet kur kolegji gjykues konstaton se kushtet nuk janë përmbushur, do të lëshoj një urdhër për paraqitësin e kërkesës në të cilën përshkruhet një kohë e caktuar mbrenda së cilës kërkesa e paraqitur duhet të përmirësohet ose plotësohet, urdhër i cili duhet t'i referohet se në cilën mënyrë kërkesa nuk i ka përmbushur kërkesat dhe që urdhëri duhet t'i dorëzohet paraqitësit të kërkesës.

Në dritën e këtij interpretimi, Gjykata Supreme konsideron se detyra e Sekretariatit Ekzekutiv *“të lehtësoj mbledhjen e kërkesave”* domodoshmërisht përfshin edhe mbledhjen e kërkesave të plotësuara të paraqitura, që nënkupton rolë aktivë dhe të efektshëm në përgatitjen e kërkesavë të plotësuara me qëllim të referimit në Komision.

Gjykata Supreme, në rastin konkret, nga shkresat e lëndës vëren se M.M. ishte kontaktuar formalisht përmes telefonit me 13 maj 2009 dhe 13 gusht 2009, dhe i është kërkuar atij që të ofronte autorizimin e bartësit të së drejtës pronësore ose anëtarit të ngushtë të familjes së bartësit të së drejtës. Atij i është dhënë afat kohor prej 30 ditësh. Me datë 13 gusht ai edhe ashtu ishte informuar se kërkesa e tij në të kundërtën do të hedhej poshtë.

Duke marrë parasysh pasojat e hedhjes së kërkesës së paraqitur për procedurën e cila nuk mund të rifilloj, meqë sipas nenit 8 të UA 2007/5 i ndryshuar, afati për paraqitjen e

kërkesës pranë KPKK-ës ka kaluar me 3 dhjetor 2007, Gjykata Supreme gjen se vetëm kërkesa në formën e shkruar të saj duke përfshirë edhe citimin e pasojave për shkak të mosplotësimit të kriterëve të kërkuara për sa i përket pranueshmërisë së kërkesës, e dorëzuar palës, mund të shërbej si bazë për refuzimin e kërkesës.

Në rastin në fjalë, një kërkesë e tillë nuk është bërë. Prandaj, përfaqësuesi i paraqitësit të kërkesës nuk ka mund të ishte në dijeni për qartësinë e kërkuar se kërkesa e paraqitur mund të hudhet poshtë për shkak të mungesës së autorizimit. Kur ai kuptoi ndikimin që kishte kjo mungesë, kur edhe e pranoi vendimin e KPKK-ës, ai paraqiti autorizimin e duhur, valid dhe të vërtetuar së bashku me ankesën e tij.

3. Si rezultat i arsyetimit të dhënë ligjor, sipas nenit 13.3 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, Gjykata Supreme do të pranojë ankesën. Sidoqoftë, Gjykata Supreme ishte e penguar në nxjerrjen e gjykimit përfundimtar. Kushtet e nxjerrjes së vendimit përfundimtar nuk ishin plotësuar, meqë njoftimi i kërkesës së paraqitur nuk ishte bërë në mënyrën e duhur.

Neni 10.1 i Rregullorës së UNMIK-ut 2006/50 i ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 përshkruan: *“Pas pranimit të kërkesës, Sekretaria Ekzekutive e njofton dhe i dërgon nga një kopje të kërkesës çdo personi, përpos paditësit, i cili aktualisht ushtron apo pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës dhe bën përpjekje të arsyeshme për të njoftuar çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në këtë pronë”*. Me këtë rast, sidoqë të jetë, Gjykata Supreme gjen se përpjekjet e AKP-ës për të njoftuar nuk kanë qenë të mjaftueshme, dhe që nënkupton shkelje serioze të:

- Njoftimit të vitit 2008 (duke vendosur lajmërimin në vendin ku gjendej ngastra e pretenduar) i cili nuk ishte konsideruar valid nga vet AKP-ja, i cili kishte përsëritur njoftimin e vitit 2010.
- Në vitin 2010, sidoqoftë, AKP-ja kishte kufizuar veten në publikimin e kërkesës dhe kishte shpërndarë Gazeten në fshat dhe në institucione tjera. Kjo e vetme dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet si “përpjekje të arsyeshme” në kuptim të Nenit 10.1 të Rregullorës së UNMIK-ut të ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079 (shih vendimin e Gjykatës 1 mars 2012, GSK-KPA-A-60/11). AKP-ja do të duhej të kishte vendosur afishen në ngastrën e kërkuar gjithashtu, meqë kjo do të rriste në mënyrë të konsiderueshme mundësinë që pala e interesuar të vihej

në dijeni për kërkesën e parashtruar. Vendosja e afishes do të ishte jo më shumë se sa “përpyetje e arsyeshme” e nevojshme. Gjykata ka vërejtur se kësij lloj njoftimi ishte zgjedhur nga AKP-ja në shumicën e rasteve, njoftimi përmes publikimit zakonisht është bërë si masë shtesë. Për më shumë, në vitin 2008 AKP-ja ka bërë njoftimin e ngastrës kontestuese në këtë mënyrë.

Gjykata nuk mund të përjashtojë faktin se dikush i cili do të ishte njoftuar në mënyrën e duhur për kërkesën e paraqitur dhe i cili e kishte uzurpuar ngastrën do të mund të përgjigjej në kërkesë. Në këtë rast, pala përgjegjëse në kërkesë ka mundur të ndëgjohej jo vetëm nga Gjykata Supreme, por gjithashtu edhe në procedurën e instancës së parë, në KPKK-ës. Prandaj, Gjykata Supreme duke anuluar vendimin e KPKK-ës është e detyruar që njoftimin e paraqitur sipas kërkesës ta vendos në mënyrë e parashikuar me ligj në ngastrën e kontestuar duke evituar kështu shkeljet thelbësore.

Shpenzimet gjyqësore:

Meqenëse vendimi i KPKK-ës është prishur dhe lënda është kthyer për rishqyrtim, shpenzimet e procedurës do të vendosen nga KPKK-ja si instancë e parë (Neni 465.3 LPK-ës).

Këshilla ligjore

Sipas nenit 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 e ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është përfundimtar dhe i ekzekutueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet përmes mjeteve të zakonshme dhe të jashtëzakonshme.

Anne Kerber, Gjyqtare Kryesuese e EULEX-it

Elka - Filcheva Ermenkova, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtarë

Urs Nufer, Regjistruer i EULEX-it